



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1864 prot.

Tiranë, më 02.02.2026

**NJOFTIM PËR POZICIONIN VAKANT "INSPEKTOR" NË DREJTORINË E INSPEKTIMIT/DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT**

Në mbështetje të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 8 /2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", Urdhërit të Kryeministrit Nr. 117, date 26.08.2025 "Për disa ndryshime në Urdhërin nr.222, datë 14.12.2023 të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", si dhe Udhërit Nr.128, datë 14.10.2025 "Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve punonjës pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror". Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit shpall në faqen zyrtare të saj njoftimin për personat e interesuar për pozicionin:

**1 (një) Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit/Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.**

- **Kategoria e pagës:** Klasa III-1 (sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar)
- **Lloji i punës:** Punë me kohë të plotë ( 8 orë në ditë, me afat të caktuar)


**Detyrat kryesore:**

a) hartimi i dokumenteve përgatitore gjatë fazës së shqyrtimit fillestar, verifikimit dhe hetimit disiplinor rreth shkeljeve të pretenduara disiplinore të përmbaruesve gjyqësor shtetëror;

b) mbledhjen e të dhënave dhe vlerësimin e çdo informacioni ose akti që çmon se është ose mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e detyrës, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror", urdhrat dhe udhëzimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit;

c) kryen evidentimin e fakteve dhe mbi veprimtarinë konkrete të përmbaruesve gjyqësor shtetëror, duke përgatitur relacionet përkatëse sipas orientimeve të Drejtorit të Inspektimit

d) kryen verifikimin e problematikave apo informacioneve të lidhura me çështjen, të përcjella nga Kryetarët e Zyrave Përmbarimore vendore si dhe përmbaruesit gjyqësor;



e) merr pjesë dhe harton procesverbale për marrjen në pyetje të përmbartuesve gjyqësor shtetëror, dëshmitareve apo personave të tjerë si dhe proces-verbale për kryerjen e veprimeve të tjera verifikuese;


f) kryen të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprorët si dhe Rregullorja e Brendshme e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor.

### **I. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidati:**

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe në të folur dhe të shkruar;
4. Të jetë në kushtet shëndetësore që lejojnë kryerjen e detyrave përkatëse;
5. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë;
6. Të zotërojë diplomën Master i Shkencave në fushën e Drejtësisë ose i barasvlefshëm me të.
7. Të ketë përvojë pune mbi 3 (tre) vjet si jurist.
8. Të ketë aftësi të mira komunikuese.
9. Të respektojë etikën dhe komunikimin me qytetarët që drejtohen pranë institucionit;
10. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi ose të mos jetë larguar me masë disiplinore “Shkarkim nga detyra” që nuk është shuar sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës Republikës së Shqipërisë”.

### **II. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

1. Kërkesë për aplikim për pozicionin;
2. Curricilum Vitae
3. Fotokopje e noterizuar e diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor).Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njësimi nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve).
4. Çdo dokument tjetër që vërteton mesataren e ponderuar të diplomës, listë notash, trajnime , kualifikime , vlerësime pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
5. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën e punës).
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

- 
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  8. Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
  9. Vërtetim nga Prokuroria e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim
  10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit, që nuk ka çështje penale në ngarkim
  11. Vërtetim për detyrimet përmbartimore

### **REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PRAPRAK.**

Në datën **09.02.2026** Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit do të njoftojë elektronikisht të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret për kualifikim, si dhe do të njoftojë datën, orën dhe vendin e saktë ku do të zhvillohet provimi me shkrim si dhe intervista. Si dhe në të njëjtën datë do të njoftohen edhe kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e pranimit në mënyrë elektronike për shkaqet e moskualifikimit.

### **FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA.**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) ligji nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror", Kodi i Etikës së përmbartuesit gjyqësor shtetëror, si dhe aktet nënligjore në fuqi;
- c) Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë;
- ç) Kodi i Familjes;
- d) ligji nr. 9695, datë 19.3.2007 "Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", i ndryshuar;
- dh) ligji nr. 9699, datë 18.12.2006 "Për masa mbrojtëse ndaj ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar;
- e) Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- ë) ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundravajtjet administrative";
- f) ligji nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar;
- g) ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- gj) ligji nr. 110/2016, "Për falimentimin";
- k) Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë;
- l) Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë;
- m) ligji nr. 79/2020 "Për ekzekutimin e vendimeve penale".

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës,
- b) Eksperencën e tyre të mëparshme,
- c) Motivimin, aspiratat dhe prishmëritë e tyre për karrierën.

#### **DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT,**

Metodologjia e vlerësimit është e publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit. Në përfundim të procedurës së vlerësimit, Drejtorja e Përgjithshme do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët do të njoftohen mbi rezultatet në adresën e tyre elektronike.

Dokumentat duhet të dorëzohen dorazi ose nëpërmjet postës zyrtare në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit me adresë sheshi, "Mustafa Qemal Ataturku", Njësia Administrative nr. 7, kryqëzimi 21 dhjetorit, Tiranë, deri në datën 09.02.2026

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**Ergys Qirici**

